

## “Bashkëpunimi ndër-institucional në fushën e politikave kundër korrupsionit”

Dhjetor 2017

Pavarësisht reformimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor për veprat penale të korrupsionit, niveli i ndëshkueshmërisë nga gjyqësori mbetet në nivele shumë të ulëta, sidomos për veprat e korrupsionit pasiv dhe aktiv të funksionarëve të lartë, të të zgjedhurve vendore, trupës së gjyqësorit apo hetuesisë.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, vlerëson se në lidhje me luftën kundër korrupsionit, Shqipëria është "deri diku e përgatitur". Raporti thekson miratimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve. Po ashtu, BE vlerëson faktin që prokuroria dhe policia kanë rritur aksesin në regjistrat elektronikë kombëtarë publikë, me qëllim shkëmbimin e informacionit sensitiv dhe rritjen e efikasitetit të hetimeve. I njëjti raport thekson se nevojitet përpunim i mëtejshëm për krijimin e një historiku të qëndrueshëm (*track record*) të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve, më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin në nivel të lartë, dhe përmirësim të bashkëpunimit ndër-institucional.

Reforma në Drejtësi është një reformë kryesore e infrastrukturës ligjore dhe institucionale e institucioneve kyçe që hetojnë dhe ndëshkojnë korrupsionin. Por për të dhënë rezultatet e shumëpritura, nevojitet gjithashtu përgatitja e kuadrit rregullator dhe mekanizmave të ndër-veprimit dhe bashkëpunimit të institucioneve në reformim. Bashkëpunimet ad-hoc, rast pas rasti, pa burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, ose shabllone të marra *copy-paste* nga shtete krahasimisht të ngjashme, duhet të zëvendësohen me marrdhënie të

strukturuara afatgjata, që respektojnë kuadrin institucional dhe ligjor në Shqipëri, si dhe rrugëtimin e vendit drejt BE-së.

Po ashtu nevojitet të promovohen modele të suksesshme bashkëpunimi, në të cilat zbatimi i de-politizuar i normave dhe procedurave jep rezultate të prekshme, ndërton institucione të qëndrueshme dhe rrit besimin e qytetarëve tek qeverisja.


Autorët kanë marrë në shqyrtim dy prej instrumentave kryesore të përdorura aktualisht në koordinimin dhe rregullimin e marrëdhënieve ndër-institucionale: (i) Memorandumet e Bashkëpunimit (MeB) - janë analizuar në mënyrë të imtë 72 MeB, sic paraqiten në tabelën e mëposhtme; dhe (ii) Strategjinë Ndër-Sektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020.

Tabelë Nr.1: Nivelet e bashkëpunimit (MeB) në shifra

Memorandume	Total	%
Qeveri - Institucione të Pavarura / Kushtetuese	39	54%
OSHC - Institucione të Pavarura/ Kushtetuese / Qeveri	11	15%
Institucione të Pavarura - Kushtetuese	13	18%
Institucione Kushtetuese	3	4%
Të tjera	6	8%
Total	72	100%

MeB kanë pësuar një rritje eksponenciale të përdorimit në vitet e fundit dhe shumica dërrmuese e tyre synon rregullimin e shkëmbimit të informacionit – detyrë kjo funksionale e institucioneve – dhe qasjen në informacion.

Grafik Nr.1: MeB ndër vite




Dy MeB veçohen si unike në kuptimin e rëndësisë së objektivave, numrit të lartë të institucioneve palë, dhe detyrave të detajuara që përcaktohen për secilin institucion. Këto dy Memorandume janë ai i krijimit të Njësive të Përbashkëta Hetimore dhe Memorandumet për përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhenave mbi rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara.

Instrumenti i dytë i analizuar në këtë hulumtim - Strategjia Ndër-sektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 - është politika publike kryesore në dispozicion të Qeverisë Shqiptare për të modernizuar qeverisjen në Shqipëri dhe luftuar korrupsionin. Kjo strategji bazohet në një qasje të trefishtë: parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, e cila vë bashkë në një plan veprimi 3-vjeçar me kosto 12 Milionë Euro, rreth 49 Ministri dhe Drejtori Varësie, 12 Prefektura dhe një seri Institucioneve të Pavaruara dhe Kushtetuese.

Plani i Veprimit i Strategjisë numëron 191 masa, prej të cilave 143 Masa me karakter parandalues, 26 Masa me objektiv madhor ndëshkimin e korrupsionit dhe 22 Masa me karakter ndërgjegjësues. Për zbatimin e çdo Mase identifikohet Institucioni Përgjegjës dhe Institucionet e tjera Bashkëpunuese.

Zbatimi i 83 Masave nga 191 kërkon bashkëpunimin e institucionit përgjegjës me një ose me shumë Institucione Bashkëpunuese.

Grafik Nr.2: Bashkëpunimi në shifra (Masat e Strategjisë)



Zbatimi i 22 nga 26 Masave total me qëllim ndëshkimin e korrupsionit bazohet tërësisht në bashkëpunimin e shumë institucioneve. Këtu psh. bëjnë pjesë masat nën objektivat B2 "Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit" apo B3 "Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar", etj. Pjesa tjetër e Masave janë përgjegjësi e një Institucioni të vetëm. Në këtë këndvështrim, vetë suksesi i zbatimit të Strategjisë varet nga bashkëpunimi institucional për zbatimin e detyrave me afat të përcaktuar nga Strategjia.

Studimi i kryer synon të ofrojë një kontribut në lëmin e politikave ndërgjegjësuese dhe parandaluese të korrupsionit, duke hedhur dritë mbi një fushë të patrajtuar mjaftueshmërisht deri më sot në politikën anti-korrupsion - atë të bashkëpunimit ndër-institucional në luftën kundër korrupsionit. Konkluzionet e saj synojnë të krijojnë bazën për një reflektim shumë-nivelësh mbi rëndësinë e koordinimit institucional dhe të ndertimit të institucioneve të qëndrueshme, sidomos në aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare. Analiza gjithashtu synon të ngrejë vemendjen mbi nevojën për rritjen e transparencës së veprimtarisë publike, konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit planifikues dhe monitorues strategjik, si dhe rëndësinë e mbështetjes së monitorimeve dhe vlerësimeve nga ana e shoqërisë civile.